

**DEKRET**  
**Nr.4805, datë 2.3.1971**

**MBI DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVE TOKËSORE TË  
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.4352, datë 23.12.1967 “Mbi këshillat popullore”,

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR I  
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**I. Në rrethin e Beratit:**

1. Lokalitetet e Shpiragut dhe Roshnikut prishen.
2. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Sinjë me fshatrat:Sinjë, Mbolan dhe Mbjeshovë.
3. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Paftal me fshatrat:Paftal, Mbreshtan, Galina, Sadovicë dhe Kamçisht.
4. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Levan-Plak me fshatrat:Levan-Plak, Metoh, Velçan dhe Mal i Bardhë.
5. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Roshnik me fshatrat: Roshnik, Mimias, Kostren i vogël, Kostren i Madh dhe Vojnik.
6. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Karkanjoz me fshatrat: Bogdan i Sipërm, Bogdan i poshtëm, Peruisnake dhe Tomorr.
7. Fshati Osmënzezë i lokalitetit të Shpirakut lidhet me rrethin.
8. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Dardhë me fshatrat: Dardhë dhe Qaf-Dardha.

**II. Në rrethin e Elbasanit:**

1. Lokalitetet e Krrabës, Labinotit, Shpatit dhe Zeranikës prishen.
2. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Gracen me fshatrat: Bodini, Graceni, Gjorma, Mamëli, Pajenga, Plangarica, Shëngjini dhe Tërbaçi.
3. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Labinot fushë me fshatrat: Griqani, Guri i Zi, Labinoti fushë, Labinoti mal, Prapanika, Serica dhe Xibraka.
4. Fshati Godolesh shkëputet nga vartësia e drejtpërdrejtë e rrethi dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Labinot Fushë.
5. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Benë me fshatrat: Bena, Lugaxhiu, Qafa dhe Qerreti.
6. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Mollagjesh me fshatrat: Korra, Krraba e vogël dhe Mollagjeshi.
7. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Branesh me fshatrat: Bixëlleja, Braneshi, Cëruja dhe Preça e Sipërme.
8. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Zavalinë me fshatrat: Joronishti, Kamiçani, Lukani, Nezhani, Selta dhe Zavalina.
9. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Gjinar me fshatrat: Derstila, Gjinari, Lleshani, Pashtrashë, Sterstani, Valëshi dhe Xibreshi.
10. Fshati i bashkuar me qendër në Rrilë priset dhe fshatrat e tij: Letani, Preça e poshtëme dhe Rrila lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Bradashesh.
11. Fshati i bashkuar me qendër në Fush-Bull priset dhe fshatrat e tij:Fush-Bulli dhe Polisi i vogël lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Hajdaran. Ndryshohet emëri i fshatit të bashkuar nga Hajdaran në Shushicë.
12. Fshati i bashkuar me qendër në Valas priset dhe fshatrat e tij: Broshka dhe Valasi

lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Lukej Papër. Ndryshohet emri i fshatit të bashkuar Kulej-Papër në Papër.

13. Fshati Bizhutë i lokalitetit të Krrabës lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Papër.

14. Fshati i bashkuar me qendër Cacabezë priset dhe fshatrat e tij: Cacabezë dhe Garunja e Paprit lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Pajovë.

15. Fshati i bashkuar me qendër në Galushë priset. Fshati Haspiraj lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Pajovë dhe fshati galushë lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Përparim.

16. Fshati Garunja e madhe shkëputet nga vartësia e drejtpërdrejtë e rrethit dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Përparim.

17. Fshati i bashkuar me qendër në Klos priset dhe fshatrat e tij: Banja, Floqi, Klosi, Lumasi, Qafa, Qyrkani dhe Selvijasi lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Mollas.

18. Fshati i bashkuar me qendër në Topojan priset dhe fshatrat e tij: Dragot-Sulova dhe Topojani lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Mollas.

19. Fshati Shalës shkëputet nga vartësia e drejtpëdrejtë e rrethit dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Gradishtë. Ndryshohet emri i qendër fshatit të bashkuar nga Gradishtë në Shalës.

### III. Në rrethin e Gjirokastrës:

1. Fshati i bashkuar Hllomo priset dhe fshatrat e tij: Hllomo, Mavrojer dhe Çatistër lidhen me fshatin e bashkuar me qendër Poliçan.

2. Fshati i bashkuar Zhej priset dhe fshatrat e tij: Zhej-Iljar, Hoshtevë-Vithkuqi dhe Doshnica lidhen me fshatin e bashkuar me qendër Nivan.

3. Fshatrat e bashkuara Sofratikë dhe Peshkopi e poshtëpme prisen dhe fshatrat e tyre: Sofratika, Dhuvrajn, Nepravishtë, Terihat, Glin, Peshkopi e poshtme, Peshkopi-Radati dhe Vilaho goranxia lidhen me fshatin e bashkuar me qendër Frashtan.

4. Fshati i bashkuar Suhë priset dhe fshatrat e tij: Labova e sipërme, Labova e poshtme, Stegopulli dhe Suha lidhen me fshatin e bashkuar me qendër Asil Zeneli.

5. Fshati Lazarat shkëputet nga vartësia e rrethit dhe lidhet me fshatin e bashkuar "Asim Zeneli.

### IV. Në rrethin e Lushnjës:

Fshati i bashkuar Kasharaj priset dhe fshatrat e tij Kasharaj, Hajdaraj dhe Lekaj lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Karbunarë.

### V. Në rrethin e Matit:

1. Lokaliteti i Derjanit priset.

2. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Derjan, me fshatrat: Barbullej, Derjan, Dukagjini, Gjoçaj, Lami i madh dhe Zall-Gjoçaj.

3. Krijohet fshati i bashkuar me qendër në Macukull me fshatrat: Macukull, Shëlliu dhe Shqefni.

4. Fshatrat: Prelli dhe Rrembulli të lokalitetit të Derjanit lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Laç-Urakë. Qendra e fshatit të bashkuar hiqet nga fshati Laç-Urakë dhe vendoset në fshatin Prell.

5. Fshati i bashkuar me qendër në Lis priset dhe fshatrat e tij: Lisi dhe Vinjollit lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Shoshaj.

6. Fshati i bashkuar me qendër në Gurrë priset dhe fshatrat e tuhy: Domi, Shulbatra, Rrypa, Gurra e madhe dhe Gurra e vogël lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Kurdari. Qendra e fshatit të bashkuar hiqet nga fshati Kurdari dhe vendoset në fshatin Suçi.

7. Fshati i bashkuar me qendër në Dushkash priset dhe fshatrat e tij: Bushkashi,

Kokërdhoku dhe Stojani lidhen me fshatin e bashkuar me qendër në Baze.

VI. Në rrethin e Shkodrës:

1. Lokaliteti i Shllakut priset.
2. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Bukjakaj-Gegaj, me fshatrat: Barcolla, Bena, Qerreti, Oalaj-Gushta, Ukbibaj, Vukjakaj-Gegaj.
3. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Malagji-Kajvli me fshatrat: Malagji-Kajvali, Kishë-Arra, Telumë-Kllogjena dhe Vila.

VII. Në rrethin e Tropojës:

1. Priset fshati i bashkuar Shipshan dhe fshatrat e tuh: Buçaj, Papaj, lidhen me fshatin e bashkuar me qendër Tropojë.
2. Fshati Gegaj shkëputet nga vartësia e drejtpëdrejt e rrethit dhe lidhet me fshatin e bashkuar Tropojë.
3. Priset fshati i bashkuar Kërrnajë dhe fshatrat e tij: Kerrnajë, Myhejani, Shkëlzeni, Kovaçi lidhen me fshatin e bashkuar me qendër Babinë.
4. Krijohet fshati i bashkuar me qendër Dragobi me fshatrat: Dragobi, Valbonë dhe Çerem.
5. Fshati Degë shkëputet nga vartësia e drejtpëdrejtë e rrethit dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër T'pla.
6. Fshati Breg-Lumi shkëputet nga vartësia e drejtpëdrejtë e rrethit dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër Geghysen.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË  
SHQIPËRISË

Sekretari  
Bilbil Klosi

kryetari  
Haxhi Lleshi